



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 461/1 Prot.

Tiranë, më 02 .03 .2026

VENDIM

Nr. 16 , Datë 02 /03 /2026

PËR

**MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DIPLOMËS SI DHE
SUPLEMENTIT TË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT ME KOHË TË
PLOTË, TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR NË KONTRABAS” NË FAKULTETIN
E MUZIKËS, TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Mbështetur në nenin 38 , pika 3 si dhe nenin 91, pikat 1, 3 dhe 5 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin Nr. 10, datë 30.03.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu II, pika 2 e tij, në Udhëzimin nr. 11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës”, në nenin 89 të Statutit të Universitetit të Arteve, i ndryshuar, si dhe shkresën nr. 461 prot., datë 27.02.2026 të Dekanit të Fakulteti të Muzikës, nëpërmjet së cilës përcillet propozimi, Senati Akademik i Universitetit të Arteve me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së diplomës si dhe suplementit të diplomës për programin e studimit me kohë të plotë, të ciklit të parë “Bachelor në Kontrabas”, në Fakultetin e Muzikës, sipas modelit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i përcillet për procedura të mëtejshme Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI



Prof. Najada HAMZA

Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHLJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion SHIMA

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)